VENDIM
Nr. 460, datë 9.7.2014

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 248, DATË 30.4.2014, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PROGRAMIN E NXITJES SË PUNËSIMIT TË PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUARA"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3 e 8 të ligjit nr. 7995, datë 20.9.1995, "Për nxitjen e punësimit", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 248, datë 30.4.2014, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Në shkronjën "a" të pikës 1, fjalët "… në degën e sigurimeve shoqërore ..." zëvendësohen me "… në degën përkatëse të tatimeve …".

2. Në fund të shkronjës "d" të pikës 13, shtohen paragrafët, me këtë përmbajtje:

"Bëjnë përjashtim nga ky rregull personat juridikë/fizikë, të cilët kanë detyrime ndaj organeve tatimore, por në momentin e aplikimit në këtë program:

i) kanë lidhur marrëveshjet përkatëse për shlyerjen e këtyre detyrimeve dhe janë të rregullt në shlyerjen e tyre;

ii) kanë shlyer detyrimet, por kanë ende pa paguar gjobat;

iii) kanë shlyer detyrimet ose kanë vendosur garanci bankare për shumën e plotë të detyrimit, në përputhje me nenin 107, të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008, "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe janë në proces të apelimit administrativ dhe në procese gjyqësore me organet tatimore.

Këta persona duhet të jenë të pajisur me vërtetimet e lëshuara nga organet tatimore, si dhe me dokumentet përkatëse të pagesës së detyrimeve.".

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama